



GJYSËMHËNA E GJELBËR E KOSOVËS

GREENCRESCENT OF KOSOVA

1 mars 2013, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Gjendje alarmante në spitalin e Prizrenit



Në kuadër të monitorimit të punës në spitalin rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, Gjysëmhëna e Gjellbër e Kosovës njofton se në javën e tretë të muajit shkurt në këtë spital ka pasur shumë keqpërdorime të detyrës zyrtare dhe për këto keqpërdorime asnjë mjek nuk pranoi të bëhej pjesë e këtij raporti. Në çdo repart mungojnë mjetet elementare të punës për të ndihmuar pacientët e shumtë që ka ky spital.

GJGJK gjatë periudhës raportuese ka analizuar raste specifike që çojnë deri te udhëheqësit e punëve në këtë institucion shëndetësor publik. Pos mjeteve elementare si: shiringat, penjët për operime, ilaçet nga më të thjeshtat në repartin e pediatriisë mungon edhe pastërtia. Në një repart ku si pacientë janë foshnjat e shumëta dhe në të mungon kujdesi mjekësor e bënë vendin tonë të renditet pothuajse në një rang më të keq edhe se vendet e Afrikës lindore për kujdesin shëndetësor që ofron shteti për popullin e vetë.

Nga hulumtimi i bërë GJGJK njofton se shumë lloje të barnave janë brenda spitalit por ato nuk janë në dispozicion të pacientëve në nevojë sepse stafi mjekësor ka preferenca se nga ku pacientët mund të marrin barëra. GJGJK kërkon nga zyrtarët komunal të Komunës së Prizrenit dhe nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës që të marrë masa të nevojshme për të evituar këto kushte jo normale që janë në spitalet e Kosovës.

Gjithashtu Gjysëmehëna e Gjelbër e Kosovës njofton të gjithë qytetatët që të jenë bashkëpunues në këto monitorime dhe të lajmërojnë për çdo keqtrajtim apo moskryerje me rregull të punës zyrtare nga personat përkatës përmes web faqes zyrtare të GJGJK-së: www.greencrescent.eu apo përmes tel. 00377(44)925083.











Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

Zyra për informim e GJGJK

Rr. Mehmet Pasha, Nr: 08,

PRIZREN

0037744925083

gjysemhenaegjelber@gmail.com

www.greencrescent.eu